



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.68

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.390, datë 21.6.200	Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.....	1887
Vendim i KM nr.391, datë 21.6.2006	Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.....	1888
Vendim i KM nr.394, datë 21.6.2006	Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore.....	1896
Vendim i KM nr.396, datë 21.6.2006	Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore.....	1898
Vendim i KM nr.397, datë 21.6.2006	Për miratimin e planveprimit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.....	1899
Vendim i KM nr.398, datë 21.6.2006	Për një shtesë në vendimin nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të pranimi në universitetet dhe shkollat e larta për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, si dhe për përcaktimin e tarifave të shkollimit për këtë vit akademik.....	1904
Vendim i KM nr.399, datë 21.6.2006	Për rritjen e pensioneve.....	1905
Vendim i KM nr.400, datë 21.6.2006	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve.....	1907
Vendim i KM	Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve.....	1908

nr.401, datë 21.6.2006

Vendim i KM nr.402, datë 21.6.2006	Për shpalljen e ekosistemit natyror të malit të Dajtit “Park Kombëtar” (me sipërfaqe të zgjeruar).....	1909
Vendim i KM nr.403, datë 14.6.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.....	1912
Vendim i KM nr.404, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1916
Vendim i KM nr.405, datë 14.6.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe pagat e punonjësve të policisë së ndërtimit”, të ndryshuar.....	1922
Vendim i KM nr.407, datë 21.6.2006	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës.....	1923
Vendim i KM nr.408, datë 21.6.2006	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Avokatit të Popullit, të disa mjediseve për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.....	1937
Vendim i KM nr.409, datë 21.6.2006	Për dhënien me qira, pa konkurrim, shkollës “Tirana International School”, të mjediseve në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.....	1940
Vendim i KM nr.414, datë 7.6.2006	Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a., të shërbimeve, postare dhe financiare, të ministrive, institucioneve buxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital shtetëror...	1940
Vendim i KM nr.415, datë 28.6.2006	Për lejimin e kalimit transit të një kompanie ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë për në Republikën e Maqedonisë.....	1941
Vendim i KM nr.416, datë 28.6.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	1942

VENDIM
Nr.390, datë 21.6.2006

PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE REGJISTRIMIN E FERMAVE BLEGTORALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja “b”, e 32, pika 6, të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritet përgjegjës për regjistrin kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale është drejtoria, që mbulon fushën e veterinarisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Fond kundërparti”, është fondi i krijuar nga pagesat e fermerëve për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe që përdoret për blerjen, në vazhdimësi, të materialeve për funksionimin e këtij sistemi.

b) “Operator privat” është personi i kontraktuar nga sektori veterinar i qarkut, për zbatimin në terren të identifikimit të kafshëve.

3. Drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit (sektori veterinar i qarkut) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, nëpërmjet specialistëve privatë, veterinerë dhe zooteknikë, me të cilët lidhin kontratat përkatëse.

4. Fermerët kontribuojnë në përballimin e kostos financiare për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe për regjistrimin e fermave blegtorale, si dhe për pagesën e bazës materiale dhe për shërbimin e kryer nga operatorët privatë.

5. Pagesa e fermerëve për shërbimin e ofruar bëhet drejtpërdrejt tek operatorët privatë, në vlerat, si më poshtë vijon:

a) Për gjedhin — 100 (njëqind) lekë, për çdo kafshë të matrikuluar.

b) Për bagëtitë e imta-20 (njëzet) lekë, për çdo kafshë të matrikuluar me matrikul individual dhe 5 (pesë) lekë për kre, për matrikulimin e kafsheve të reja, për therje.

Në shërbimin e kryer nga operatori privat përfshihen matrikulimi i kafshës dhe plotësimi i formularëve respektivë.

6. Pagesa e fermerëve për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale mbledhet nga operatorët privatë në çastin e matrikulimit të kafshëve dhe depozitohet në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të cilat e derdhin këtë shumë në një numër të veçantë llogarie, për Institutin e Kërkimeve Veterinare për krijimin e fondit kundërparti.

Ky fond të përdoret për blerje, në vazhdimësi, të materialeve për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhëzimit përkatës të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, përcakton çmimin e bazës materiale që do të paguajnë fermerët, në bazë të konkurrencës së jo më pak se tri ofertave.

7. Organet e qeverisjes vendore dhe të Policisë së Shtetit bashkëpunojnë dhe mbështesin drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit për zbatimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.19, datë 28.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.391, datë 21.6.2006

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e materialit drusor të asortuar, që shitet në anë të rrugës, përcaktohen sipas çmimeve të tregut, por jo nën çmimin e kostos së prodhimit, e cila përllogaritet mbi tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë, që jepen në lidhjet 1/a e 1/b, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit, pyjor e kullosur, publik, zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 2, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për ngritje kampingjesh, qendrash shlodhëse dhe objektsh të lëvizshme, zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 3, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Për heqjen e miratuar të sipërfaqeve nga fondi pyjor publik zbatohen përllogaritjet sipas lidhjes 4, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta në fondin, pyjor e kullosur publik, zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 5, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Për shitjen e pemëve të Krishtlindjeve dhe të Vitit të Ri zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 6, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Për shitje fidanësh nga ripërtëritja natyrore, të shpatullave dhe të kalemave, zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 7, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor zbatohen tarifat e përcaktuara në lidhjen 8, të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Vendimi nr.449, datë 26.6.2003 i Këshillit të Ministrave “Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe vendimi nr.236, datë 21.4.2005 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.449, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, shfuqizohen.

10. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA PËR TARIFAT NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË KULLOTAVE

Lidhja 1a

TARIFAT BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

Nr.rendor	Emërtimi	Njësi matje	Tarifa (lekë)	
			E hollë deri 22 cm	E mesme dhe e trashë mbi 22 cm
	1. Lëndë punimi në këmbë a) Halorë			
1	Pishë	m ³	1800	2500
2	Bredh etj.	m ³	1800	2500
	b) Fletorë			
1	Ah	m ³	1300	2400
2	Dushk	m ³	1500	2700
	II. Dru zjarri a) Të forta			
1	Dushk, ah, panjë, frashër, rrap, akacie, lojfatë, gështenjë, mare, shkozë, mëllezë, bli, lajthi, thanë, mrete, bush.	m ³	160	
	b) Të buta			
1.	Halorë, shëlg, plep dhe vërr	m ³	80	

Lidhja 1b

TARIFË BAZË TË LËNDËS DRUSORE NË KËMBË, PËR LLOJET INDUSTRIALE

Nr.ren.	Emërtimi	Njës.matje	Tarifa (lekë)
	Lëndë druri në këmbë		
1	Arrë, gështenjë, panjë, vidh	m ³	4500
2	Carac, ekualipt, man, mëllezë, plep, rrap, shëlg, shkozë.	m ³	1700
3	Bli, frashër, gështenjë e egër, mëshhtëknë, vërr	m ³	3300

Shënime.

1. Tarifat e përcaktuara në lidhjet 1a dhe 1b shërbejnë si bazë për të përlogaritur koston e prodhimit për lëndën drusore të asortuar që trajtohet në pikën 1 të vendimit.

2. Kur lënda e punimit dhe drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, por materiali drusor është i përdorshëm, tarifat për to do të jenë 50% më të ulëta se tarifat bazë.

Lidhja 2

TARIFAT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE TË FONDIT PYJOR PUBLIK

Tarifa (lekë/ha/vit) për:

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Koha e	Pyjet e larta	Pyjet e ulëta,	Tokat me bimësi
-----	----------------------	--------	---------------	----------------	-----------------

		përdorimit		shkurret dhe kullotat	pyjore dhe sipërfaqet inproduktive
1	Ndërtim për qëllime pushimi dhe argëtimi (kënde lojrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.)	Deri 3 vjet 4-5 vjet	150.000 105.000	105.000 75.000	75.000 45.000
2	Për qëllime shëndetësore	Deri 5 vjet 6-10 vjet 11-15 vjet	10.000 8.000 6.000	8.000 6.000 4.000	6.000 4.000 2.000
3	Për qëllime kërkimore, studimore, baza didaktike dhe eksperimentale	Deri 10 vjet 11-15 vjet 16-20 vjet	5.000 4.000 3.000	4.000 3.000 2.000	3.000 2.000 1.000
4	Ndërtim objekte tregtie, bare, restorante, hotele, karburanti	Deri 5 vjet 6-10 vjet	6.000.000 5.700.000	5.700.000 4.000.000	4.000.000 2.700.000
5	Për nxjerrje dhe prodhim materialesh inerte për ndërtim, tregti, qëllime industriale ose përpunuese, direkt nga sipërfaqja (karrierë)	Deri 5 vjet 6-10 vjet 11-20 vjet	450.000 4 10.000 370.000	430.000 390.000 350.000	410.000 370.000 330.000
6	Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit.	Deri 5 vjet 6-10 vjet 11-20 vjet	9.000.000 7.500.000 6.000.000	6.300.000 5.100.000 3.900.000	4.200.000 3.150.000 2.250.000
7	Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose për punime të ndryshme (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse)	Deri 10 vjet 11-20 vjet	200.000 160.000	160.000 130.000	130.000 110.000
8	Për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare (gërmime dhe depozitime materialesh në sipërfaqe), ngritje objektesh të ndryshme	Deri 5 vjet 6-10 vjet 11-15 vjet	100.000 80.000 64.000	80.000 64.000 51.000	64.000 51.000 40.000
9	Për shpim-kërkim uji, gazi, naftë, shtrirje tubacionesh në sipërfaqe, ndërtim kanalesh	Deri 5 vjet 6-10 vjet	200.000 160.000	160.000 130.000	130.000 100.000
10	Për ndërtim rezervuarësh për zhvillimin e akuakulturës	Deri 5 vjet 6-10 vjet	300.000 225.000	225.000 150.000	150.000 105.000
11	Për mbarështrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme	Deri 10 vjet 11-20 vjet 21-30 vjet	20.000 18.000 16.000	18.000 16.000 14.000	15.000 12.000 10.000
12	Për mbarështrimin e faunës së egër	Deri 10 vjet 11-20 vjet 21-30 vjet	30.000 20.000 15.000	20.000 15.000 13.000	15.000 13.000 10.000
13	Ndërtim furre për prodhimin e gëlqeres	Deri 5 vjet 6-10 vjet	200.000 150.000	150.000 100.000	100.000 70.000
14	Vendosje kamine për prodhimin e qymyrit të drurit dhe eshkës së kovaçit.	Deri 5 vjet	200.000	100.000	80.000
15	Ndërtim linje të tensionit të lartë	Për të gjithë kohën e funksionit të linjës	50.000	30.000	
16	Ndërtim rruge për lidhjen e	E njëjtë me	50.000	40.000	30.000

	sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues	atë të sipërfaqes së dhënë në përdorim			
--	--	--	--	--	--

Lidhja 2/1

TARIFAT PËR PËRDORIMIN E SIPËRFAQEVE PYJORE, KULLOSORE DHE TË TOKAVE ME BIMËSI PYJORE, TË PËRFSHIRA NË STUDIMET E MIRATUARA NGA KRTRSH-JA

Tarifa (lekë/ha/vit):

Qëllimi i përdorimit	Zona malore	Zona kodrinore	Zona fushore	Zona me përparësi zhvillimin e turizmit
Qendra ose komplekse pushimi, kurimi dhe turistike	50.000	70.000	100.000	120.000

Lidhja 3

TARIFAT PËR NGRITJEN E KAMPINGJEVE, QENDRAVE DHE OBJEKTEVE TË LËVIZSHME

Nr.rend.	Emërtimi	Tarifa (lekë/ditë/copë)
1.	Çadra deri 4 vende	100
2.	Çadra mbi 4 vende	200
3.	Ruletë	500
4.	Barakë portative	250

Lidhja 4

TARIFAT PËR HEQJEN ME MIRATIM TË SIPËRFAQEVE NGA FONDI PYJOR PUBLIK

Tarifat për pjesë të fondit pyjor publik, që hiqen prej tij sipas nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, përllogariten duke mbajtur parasysh:

1. Çmimin e tokës sipas tregut, në momentin që bëhet heqja.
2. Vlerën e pyllit (i lartë, i ulët dhe shkurre, toka me bimësi pyjore dhe të zhveshura, tokat inproduktive).
3. Vlerësimin e florës e të faunës dhe të përbërësve të tjerë që i përkasin kësaj sipërfaqeje, të cilat do të përcaktohen sipas studimeve të veçanta për çdo rast konkret.

Lidhja 5

TARIFAT PËR GRUMBULLIMIN DHE NXJERRJEN E PRODHIMEVE TË DYTA

Nr.ren.	Emërtimi	Njës.matj.	Tarifa (lekë)
A. Grumbullim në fondin pyjor dhe kullor:			
1.	Fashina, shkarpa	mst	35
2.	Mbeturina pylli të çdo lloji	m ³	40
3.	Thupra të çdo lloji	kv	55

4.	Kucka, rrënjë	kv	100
5.	Cungje	m ³	150
6.	Hunj	000/copë	160
7.	Bandiera	000/copë	290
8.	Eshkë kovaçi	kv	90
9.	Katran	kv	700
10.	Rrëshirë pishe	kv	350
11.	Bar për blegtorinë	kv	20
12.	Gjethë për blegtorinë	kv	40
13.	Lule të ndryshme	kv	450
14.	Gjethë të ndryshme	kv	150
15.	Rrënjë të ndryshme	kv	250
16.	Herba të ndryshme	kv	70
17.	Fruta, fara dhe sytha	kv	500
18.	Lëvore	kv	350
19.	Kërpudha	kv	2500
20.	Boçe të ndryshme	kv	200
21.	Degë të gjelbëra, me dhe pa lule, për buqeta	kv	100
B.	Nxerrja ose grumbullim në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor:		
a)	Gurë, rrëzë dhe zhavorr	m ³	35
b)	Dhé dhe humus	m ³	60
c)	Prodhim qymyr druri në sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor	kv	100

Shënim. Tarifat e germës a, të pikës B të përdoren vetëm në rastin kur grumbullimi i materialeve të ndërtimit bëhet nga banorët e zonave rurale, për nevojat e tyre vetjake.

Në mbeturinat e pyllit do të futet vetëm ai material drusor (i kalbur, gjysmë i kalbur), i cili nuk plotëson parametrat për dru zjarri.

Lidhja 6

TARIFAT E SHITJES SË PEMËVE TË KRISHTLINDJEVE DHE TË VITIT TË RI

Nr.ren.	Specifikimi	Njësia e matjes	Tarifa (lekë)
1.	me lartësi deri në 1 m	copë	1000
2.	me lartësi 1 deri 3m	copë	2000
3.	me lartësi 3 deri 5 m	copë	3000
4.	me lartësi 5 deri 7 m	copë	5000
5.	me lartësi mbi 7 m	copë	10000

Lidhja 7

TARIFAT E SHITJES SË FIDANËVE NGA RIPËRTËRITJA NATYRORE, E SHPATULLAVE DHE E KALEMAVE

Nr.ren.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa (lekë)
1.	Fidanë, shpatulla dhe kalema:		
	- me moshë 1-vjeçare	copë	10
	- me moshë 2-vjeçare	copë	30
	- me moshë mbi 2-vjeçare	copë	50

TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË FONDIN PYJOR

Nr.	Emërtimi i dëmit	Njësia e matjes	Vlera (lekë)
1	Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh me diametër:		
	-deri në 2 cm	copë	250
	-nga 2.1-4 cm	copë	500
	-nga 4.1-6 cm	copë	2.700
	-nga 6.1-8 cm	copë	3.100
	-nga 8.1-10 cm	copë	5.100
	-nga 10.1-20 cm	copë	8.000
	-nga 20.1-30 cm	copë	15.000
	-nga 30.1-40 cm	copë	20.000
2	-nga 40.1-60 cm	copë	24.000
	-mbi 60 cm	copë	34.000
	Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh në masë:		
	-në pyje të rinj (deri në 10 cm diametër)	ha	400.000
	-në pyje të rritur (mbi 10 cm diametër)	ha	650.000
	-në shkurre	ha	125.000
Shënim- Prerje në masë quhet prerja e mbi 50% të drurëve në njësi të sipërfaqes			
3	Dëmtim në çfarëdo mënyre i fidanëve, filizave e drurëve me diametër:		
	-deri në 2 cm	copë	320
	-nga 2.1-4 cm	copë	540
	-nga 4.1-6 cm	copë	760
	-nga 6.1-8 cm	copë	950
	-nga 8.1 -10 cm	copë	1.250
	-nga 10.1-20 cm	copë	1.600
	-nga 20.1-30 cm	copë	2.200
	-nga 30.1-40 cm	copë	2.700
4.	-nga 40.1-60 cm	copë	3.200
	-mbi 60 cm	copë	5.400
	Dëmtim në masë mbi 50% të sipërfaqes me çfarëdo mënyre në pyllëzimet e reja, pyjet e rinj e fidanishte:		
	-në pyllëzimet e reja, pyjet e rinj e fidanishte	ha	320.000
	-në pyje të rritur (mbi 10 cm diametër)	ha	630.000
	-në shkurre	ha	108.000
5.	Dëmtim nga zjarri:		
a)	Kur vlerësohet materiali drusor:		
	-në trungishte	ha	250.000
	-në cungishte	ha	80.000
	-në shkurre	ha	50.000
	-në pyllëzime e fidanishte	ha	200.000
b)	Kur materiali drusor është i dëmtuar plotësisht:		
	-në trungishte	ha	1.500.000

	-në cungishte	ha	700.000
	-në shkurre	ha	400.000
	-në pyllëzime e fidanishte	ha	1.200.000
6.	Shpyllëzimi i fondit pyjor ose i pyjeve pa miratimin përkatës, pa përdorimin e tokës:		
	-në trungishte	ha	7.000.000
	-në cungishte	ha	4.000.000
	-në shkurre	ha	2.000.000
	-në pjesë të tjera të fondit pyjor	ha	1.500.000
7.	Zënie ose përdorim pa leje i fondit ose i pyjeve pa i dëmtuar ato:	ha	2.500.000
8.	Përvetësim dhe shitja pa leje:		
	-lëndë punimi	m ³	60.000
	-dru zjarri	mst	30.000
	-dru zjarri ngarkese kali	barrë	9.000
	-dru zjarri ngarkese gomari	barrë	6.000
	-dru zjarri ngarkese njeriu	barrë	3.500
	-hunjtë të ndryshëm deri në diametër 4 cm	copë	1.400
	-bandiera, bishta veglash, furde e furka, e të tjera si këto me diametër 4.1-12 cm	copë	4.000
9.	Prodhim, përvetësim dhe shitje pa leje		
a.	Fruta e fara:		
	-të njoma	kg	2.300
	-të thata	kg	4.500
b.	Rrëshirë pishe e katran	kg	1.200
c.	Fletë dafine:		
	-të njoma	kg	2.300
	-të thata	kg	4.500
d.	Bimë mjekësore e tanifere:		
	-të njoma	kg	5.400
	-të thata	kg	10.000
e.	Rrënjë e kucka shqope, mare, bushi e të tjera si këto	kg	10.000
f.	Thupra shelgu e lloje të tjera të kësaj natyre:		
	-të njoma	kg	1.100
	-të thata	kg	2.000
	- të xhveshura	kg	3.000
g.	Qymyr druri, eshk kovaçi, e të tjera të kësaj natyre	copë	30.000
h.	Fuçi, kade, govata druri, e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia.	copë	15.000
i.	Kosha, shporta e të tjera të kësaj natyre prej thupra shelgu e lloje të tjera pyjore, pavarësisht nga madhësia	copë	10.000
10.	Ndërtim pa leje i furrave të gëlqeres, kamina për qymyr druri, eshkë kovaçi, katrani e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia	copë	8.000
11.	Dëmtimi ose zhdukja e objekteve të mbarështrimit, gjeodezike e topografike dhe të tjera të kësaj natyre, në fondin pyjor	copë	5.400

12.	Dëmtimi ose zhdukja e ndërtimeve apo strehimeve për shtimin e gjahut e të tjera si këto, kudo që ndodhen	copë	10.800
13	Dëmtimi ose zhdukja e pikave dhe kullave të vrojtimit për ruajtjen e florës dhe faunës nga sëmundjet, insektet dhe zjarret	copë	8.000
14.	Dëmtimi i rrethimeve në fondin pyjor ose vende të tjera si këto	ml	5.400
15	Kryerja e gërmimeve ose punimeve të tjera në fondin pyjor për nxjerrjen e gurëve, rërës, zhavorrit, dheu, humusit, plisave të barit e të tjera si këto	m ²	7.000
16.	Hapja e gropave pa leje dhe mosmbulimi i tyre	m ³	4.500
17.	Shkulja e cungjeve pa leje	copë	27.000
18.	Hapja pa leje në fondin pyjor e guroreve e karierave	m ²	45.000
19.	Hapja e rrugëve, linjave telefonike, telegrafike, televizive, gassjellëse, naftësijellëse, kanaleve, linjave të tensionit të lartë, ujësjellsve e të tjera të kësaj natyre në fondin pyjor, pa miratimin përkatës	m ³	49.500
20.	Kullotja pa leje në fondin pyjor: -për gjethet -për të leshtat -për të dhirtat -për derrat -për shpendët -për njëhundrakët	krerë krerë krerë krerë krerë krerë	2.700 1.350 1.800 2.200 450 2.200
21.	Kositja dhe grumbullimi pa leje në fondin pyjor të barit, gjetheve, krandeve e të tjera të kësaj natyre.	kv	3.500
22.	Vendosja e mullarëve të çfarëdo lloji e madhësie pa leje në fondin pyjor dhe jashtë vendeve të miratuara	copë	2.700

VENDIM
Nr.394, datë 21.6.2006

PËR KRITERET DHE RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PYJEVE DHE TË SHITJES SË MATERIALIT DRUSOR E TË PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE E JOPYJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10 të nenit 26 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret e shfrytëzimit

1. Shfrytëzimi i fondit pyjor publik përmblledh ndërhyrjet dhe trajtimet silvikulturore në jetën e pyllit, vjeljen e materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera, përpunimin dhe transportin e tyre në

moshën e shfrytëzueshmërisë dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

2. Shfrytëzimi planifikohet çdo vit, në përputhje me urgjencën e prerjeve të lejuara, sipas ngastrave dhe nënngastrave pyjore, me kërkesat e planeve të mbarështimit apo të inventarizimit, si dhe me projektet tekniko-ekonomike, të hartuara nga drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor. Në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, shfrytëzimi bëhet vetëm në rastet kur kryhen punimet e përkujdesjes dhe të prerjeve sanitare. Në zonat e mbrojtura ato kryhen në bazë të projekteve dhe në përputhje me statusin e zonës.

3. Shfrytëzimi organizohet dhe kryhet në bazë të vitit pyjor, i cili fillon në datën 1 tetor dhe përfundon në datën 30 shtator të vitit pasardhës. Për arsye objektive, ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, shtyn afatin e shfrytëzimit të vitit pyjor, por jo më vonë se data 30 qershor e vitit pasardhës.

4. Shfrytëzimi i ngastrave pyjore lejohet vetëm kur një gjë e tillë kërkohet teknikisht, në rastin e prerjeve përfundimtare, të dyta e përfundimtare, si dhe në rastin e prerjeve në pyjet e dëmtuara nga katastrofat natyrore apo nga zjarri.

5. Sasia e shfrytëzimit vjetor caktohet brenda mundësive shfrytëzuese, të përcaktuara në planet e mbarështimit apo të inventarizimit.

6. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të të gjithë materialit të përgatitur për shfrytëzimin, miraton, me urdhër, kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të dyta, pyjore dhe jopyjore.

7. Shfrytëzimi i ngastrave apo nënngastrave pyjore fillon vetëm kur subjektet e licencuara për shfrytëzimin e materialit drusor, kanë lidhur kontratën e shfrytëzimit, kanë marrë me procesverbal dorëzimi ngastrat e kontraktuara dhe janë pajisur me lejen e shfrytëzimit, sipas afateve të caktuara në kontratë.

8. Në ngastrat dhe nënngastrat, ku do të kryhen prerje të dyta e përfundimtare, shfrytëzimi bëhet në periudhën me dëborë. Kur prerjet e dyta e përfundimtare janë tepër të vonuara, shfrytëzimi lejohet edhe në periudhën e pushimit të vegjetacionit.

9. Prerja e drurëve pyjore fillon pasi bëhet shënimi i tyre me damkë të veçantë, të përcaktuar në urdhrin me shkrim të drejtorit të drejtorisë rajonale të shërbimit pyjor. Shënimi i drurëve me damkë fillon, si rregull, pas datës 15 maj dhe përfundon më 30 qershor.

10. Kërkesat, teknike e metodike, si dhe procedurat e caktimit të ngastrave e të nënngastrave për shfrytëzim, të damkosjes së drurëve, të prerjes e asortimit të tyre, të transportit e stivosjes në anë të rrugës, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

11. Nxjerrja dhe grumbullimi nga pylli i prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vrrinit, etj., i rrëshirës së pishës, i halave dhe gjetheve, i rrënjëve e lëvres, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i këpurdhave dhe nënprodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore, u lejohet pesonave, fizikë e juridikë, të pajisur me lejen përkatëse, të lëshuar nga drejtoria rajonale e shërbimit pyjor, kundrejt tarifave përkatëse.

12. Shfrytëzimi realizohet nga subjekte private, të specializuara. Përzgjedhja e subjekteve bëhet nëpërmjet tenderave, të organizuara nga organet e shërbimit pyjor, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi.

13. Tenderat zhvillohen për ngastrat dhe nënngastrat, për të cilat janë përgatitur projektet tekniko-ekonomike të shfrytëzimit dhe për të cilat garantohet efektiviteti ekonomik, miradministrimi e ruajtja e asortimenteve deri në shitjen e tyre.

14. Fondet për prodhimin e materialit drusor, të magazinuar në anë të rrugës apo në sheshet e depozitimit, planifikohen, çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

II. Caktimi dhe dorëzimi për shfrytëzim i ngastrave dhe nënngastrave pyjore

1. Subjekti, para se të marrë në dorëzim ngastrat për shfrytëzim, ka të drejtë t'i kontrollojë në vend dhe të paraqesë me shkrim vërejtjet, që mund të ketë për sasinë e vëllimit drusor dhe të asortimenteve, që do të prodhojë. Drejtoria rajonale e shërbimit pyjor, me komision, verifikon vërejtjet, dhe, kur ato janë të drejta, bën ndryshimet përkatëse.

2. Dorëzimi i ngastrës apo nënngastrës për shfrytëzim bëhet me pjesë. Pasi të ketë përfunduar shfrytëzimi i plotë i njëres pjesë, dorëzohet pjesa tjetër, deri në përfundimin e plotë të saj. Për çdo dorëzim mbahet procesverbali i kolaudimit provizor dhe, në fund, ai përfundimtar.

3. Ngastrat e nënngastrat, që dorëzohen për shfrytëzim, mbrohen nga shfrytëzuesi i materialit drusor. Ai përgjigjet për të gjitha dëmet, që mund të shkaktohen në të, deri në rikthimin e tyre me procesverbal, organeve të shërbimit pyjor.

III. Rregullat e shfrytëzimit

1. Subjekti, që merr të drejtën për shfrytëzimin e ngastrës, zbaton rregullat dhe kërkesat teknike, metodikat e procedurat operacionale për shfrytëzimin e ngastrës, të cilat specifikohen në kontratën e shfrytëzimit, në përputhje me kërkesat e skemës teknologjike të shfrytëzimit.

2. Drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor kontrollojnë mënyrën e shfrytëzimit dhe të transportimit të materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera pyjore, dhe, kur vërejnë shkelje, ndërhyjnë për riparimin e tyre. Kur vënë re shndërrimin e lëndës së punimit në dru zjarri, dhe prodhim të asortimenteve më pak të vlefshme se ato të përcaktuara në kontratën e shfrytëzimit, ato mbajnë procesverbal dhe kërkojnë nga subjekti kthimin e vlerës së dëmtuar.

3. Me përfundimin e plotë të prerjes, nxjerrjes së materialit drusor dhe pastrimeve të ngastrës, subjekti ia dorëzon ngastrën organeve të shërbimit pyjor, me procesverbal përfundimtar.

IV. Kriteret dhe rregullat e shitjes së materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore.

1. Asortimentet e gatshme, të magazinuara në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi, shiten me ankand. Shitjes me ankand u nënshtrohen edhe asortimentet e prera ilegalisht dhe të sekuestruara. Në këto raste procesverbali i sekuestrimit është pjesë përbërëse e dokumenteve të ankandit.

2. Ankandi bëhet i hapur për çdo parti asortimentesh ose për të gjitha partitë e të njëjtit asortiment, që i përkasin së njëjtës cilësi dhe që përbëhen nga i njëjti lloj drusor.

3. Ankandet organizohen dhe zhvillohen nga drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor. Nuk lejohet që asortimentet të shiten nën çmimin e kostonë së prodhimit.

4. Në ankand marnin pjesë subjektet juridike, që e tregtojnë dhe e përpunojnë lëndën drusore. Kur vëllimi i nxjerrë në shitje është më pak se 50 m³ për lëndën e punimit dhe nën 100 mst për drutë e zjarrit, në ankand marrin pjesë edhe personat fizikë.

5. Me subjektin, që shpallet fitues, hartohet procesverbal dhe lidhet kontrata, ku përcaktohen asortimenti, sipas llojit, sasia, cilësia dhe vlera e përgjithshme.

6. Subjekti, për materialin drusor të blerë, bën pagesën 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Për asortimentet drusore, deri në 200 m³ pagesa bëhet njëherësh, ndërsa për mbi 200 m³, në dy këste. Afati maksimal i pagesës së kështit të fundit është 15 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës. Pagesa për asortimentet e sekuestruara bëhet njëherësh. Çdo pagese bëhet me vlerën e plotë, sipas kësteve të vendosura në kontratë.

7. Me nënshkrimin e kontratës, drejtoria rajonale e shërbimit pyjor çlirohet nga çdo përgjegjësi për ruajtjen dhe dëmtimet, që mund të pësojë materiali drusor i shitur.

8. Kërkesat e veçanta për organizimin dhe zhvillimin e ankandit të shitjes së materialit drusor, të asortuar e të magazinuar në anë të rrugës, si dhe kriteret e rregullat e shitjes së prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore, sipas kontigjentëve, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.396, datë 21.6.2006

PËR KRITERET E TRANSFERIMIT DHE TË PËRDORIMIT TË PYJEVE NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e qeverisjes vendore, për marrjen, në pronësi ose në përdorim të pyjeve, prona publike të paluajtshme të shtetit, paraqesin kërkesën sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumente, ku përcaktohen:

a) përshkrimi teknik i pyllit, përfshirë raportin ndërmjet pyjeve të larta, trungishteve, cungishteve e shkurreve, infrastrukturën përkatëse dhe largësinë e tij nga fshatrat;

b) vendndodhja e pyllit, e pasqyruar në hartat përkatëse;

c) vërtetimi, që pylli i kërkuar nuk është në pronësi private.

3. Njësitë e qeverisjes vendore u jepen, në përdorim apo në pronësi, sipërfaqe pyjore, mbështetur në këto kritere:

a) Sipërfaqja pyjore të jetë në territorin e komunës;

b) Sipërfaqja që kërkohet, të ketë kufij të qartë ndarës me pyjet, pronë shtetërore, me pyjet e komunave kufitare dhe me pyjet, pronë private;

c) Pylli i marrë, në pronësi apo në përdorim, të shërbejë për përmirësimin e gjendjes ekonomiko-sociale të fshatit/komunës, nëpërmjet rritjes të së ardhurave nga administrimi i kësaj pasurie;

ç) Përdorimi i sipërfaqes pyjore të zbusë nevojat e domosdoshme për furnizimin e komunitetit me dru zjarri dhe për mbarështimin e blegtorisë;

d) Administrimi i pyjeve të mbështetet në traditën e komunitetit, që pasqyrohet në planin e menaxhimit;

dh) Të garantojë zbatimin e kërkesave ligjore, si dhe të kriterëve e standardeve për pyjet;

e) Të realizojë menaxhim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të pyjeve, duke kryer investimet e parashikuara në planin e menaxhimit, me financimet e veta a donacionet.

4. Njësia e qeverisjes vendore, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për kalimin në pronësi, bën regjistrimin e sipërfaqes pyjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5. Pyjet e marra, në përdorim ose pronësi, quhen pyje komunale dhe përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Respektimi i destinacionit dhe moszvogëlimi i sipërfaqes së pyllit komunal;

b) Identifikimi i përdoruesve të pyjeve komunale në nivel përdoruesi, grup përdoruesish apo fshati dhe pajisja e tyre me kartela përdorimi;

c) Ndihma për ngritjen dhe funksionimin e shoqatave të përdoruesve të pyjeve, në përputhje me ligjet në fuqi;

ç) Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit të pyjeve komunale, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Pyjeve dhe me kërkesën e parimit të zhvillimit të tyre të qëndrueshëm dhe në bashkëpunim me këto shoqata;

d) Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të komunitetit në përdorimin, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve komunale;

dh) Bashkëpunimi me strukturat rajonale të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me shoqatat e pyjeve e ato mjedisore;

e) Krijimi i fondeve për investime dhe mirëmbajtje të këtyre sipërfaqeve pyjore, në bazë të të ardhurave nga tarifat e lëndës drusore, bimëve medicinale, gjuetisë, kullotjes dhe gjobat.

6. Jo më pak se 70 për qind e fondit të krijuar sipas shkronjës “e” të pikës 6 të këtij vendimi, përdoret për përmirësimin e pyllit komunal.

7. Strukturat rajonale të pyjeve në rrethe ofrojnë shërbim këshillimor për përdoruesit e pyjeve komunale.

8. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave kontrollon zbatimin e kërkesave ligjore në përdorimin e pyjeve komunale.

9. Kur një njësi e qeverisjes vendore nuk zbaton kriteret dhe kërkesat për përdorimin e pyllit

komunal, ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e së drejtës së përdorimit të tij.

10. Rregullat e përcaktuara në këtë vendim zbatohen edhe kur njësitë e qeverisjes vendore marrin, në përdorim ose në pronësi, kullota, pronë publike të paluajtshme shtetërore.

11. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.397, datë 21.6.2006

**PËR MIRATIMIN E PLANVEPRIMIT PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE
INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planveprimit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, sipas matricës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë, prefektët dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

OBJEKTIVI	MASA	ISTITUCIONI PERGJEJGES	TREGUESIT E MONITORUESHEM	AFATI
1. Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave dhe dokumentacionit përkatës për legalizimin e ndërtimeve pa leje.	a. Hartimi dhe miratimi i vendimit "Për fotografimin ajror të territorit të vendit".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	15 ditë pas miratimit të këtij vendimi.
	b. Marrja e masave konkrete për disponimin e materialit hartografik, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.			Brenda 60 ditëve të hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
	c. Implementimi i Vendimit 289, dt. 17.5.2006 të KM "Për organizimin dhe funksionimin e ALUIZNI".			Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	d. Ngritja e strukturës qendrore të ALUIZNI.			
2. Përcaktimi i sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave dhe ngritja e një "data base".	e. Sigurimi i ambienteve të punës dhe evidentim i nevojave dhe prioriteve për ngritjen e strukturave në njësi të veçanta të qeverisjes vendore.	MPPTT Prefektët		Menjehere me miratimin e këtij vendimi
	f. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	a. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimeve pa leje dhe ngritjen e bazës së të dhënave".	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Keshillit të Ministrave	Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	b. Hartimi dhe miratimi i projekt udhëzimit "Për mënyrën e plotësimit të të dhënave për ndërtimet pa leje dhe ruajtjen e tyre".	MPPTT ALUIZNI	Udhëzim i Ministrit të MPPTT	
3. Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit për përfitimet dhe detyrimet e legalizimit të ndërtimit pa leje, për të mundësuar pjesëmarrjen e tij në çdo fazë të procesit të legalizimit.	a. Hartimi i plan veprimit të fushatës kombëtare.	MPPTT e ALUIZNI		15 ditë pas miratimit e këtij vendimi.
	b. Prodhimi dhe shumëfishimi i broshurës "Vetëdeklarimi dhe legalizimi".	MPPTT e ALUIZNI me njësitë vendore dhe		Brenda 30 ditëve nga hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
	c. Prodhimi i spoteve publicitare.			
	ç. Përgatitja dhe shpërndarja e manualëve "Mbi procesin e vetëdeklarimit".		Dokumentacioni përkatës	Gjatë përuarjes katër muajore të vetëdeklarimit
	d. Zhvillimi i fushatës sensibilizuese kombëtare me transmetim spoti, shpërndarje të broshurës dhe shumëfishim formularësh vetëdeklarimi.			Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	e. Organizimi i seminarit kombëtar me temë "Vetëdeklarimi dhe legalizimi".	MPPTT		Gjatë përuarjes
	f. Organizim konferencash shtypi, emisione televizive, tryezash të			

urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve pa leje	rumbullakta për procesin e vetëdeklarimit.	ALUIZNI		katër muajore të vetëdeklarimit
		MPPTT ALUIZNI ISPU	Vendim i KRRTRRSH	
4. Plotësimi i kuadrit ligjor të nevojshëm në mbështetje të ligjit "Për legalizimin , urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	g. Organizim i takimeve trainuese në nivel qarku.			Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	a. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të KRRTRSH "Për normat dhe standartet minimale urbanistike".	MPPTT ALUIZNI	Udhëzim i Ministrit të MPPTT	Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	b. Hartimi dhe miratimi i projektudhëzimit "Për miratimin e dokumentacionit teknik e ligjor të argumentimit dhe pasqyrim të gjendjes faktike të zonave/vendbanimeve/blokbanimeve dhe ndërtimit informal të veçuar".	MPPTT ALUIZNI	Dokumentacioni perketes	
	c. Hartimi i manualit shpjegues "mbi plotësimin e dokumentacionit për legalizimin e ndërtimeve pa leje".	MPPTT, ALUIZNI	Vendim i Këshillit të Ministrave	
	d. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret, procedurat dhe miratimin e lejes së legalizimit".	MPPTT	Urdhër i Ministrit të MPPTT	Menjehere me miratimin e këtij vendimi.
5. Ndërmarrja e masave të veçanta për përfshirjen në procesin e legalizimit dhe urbanizimit edhe të territoreve me karakteristika të veçanta.	e. Hartimi i Urdhërit "Për përcaktimin e institucionit të oponencës".	MPPTT		
	ë. Hartimin dhe miratimin e projektvendimit të KM "Për përcaktimin e koficientit të shfrytëzimit të ndërtesës", për rastet e ndërtimeve me funksion të përzier.	MPPTT ALUIZNI	Vendim i Këshillit të Ministrave	Brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	f. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të KM për "Kalimin e kompetencave nga njesitë vendore ALUIZNI-t, për realizimin e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve pa leje, me mënyra, afatet dhe kohën e realizimit".	MPPTT ALUIZNI me ministrinë e linjes		
	a. Identifikimi i territoreve të zëna nga ndërtimet pa leje brenda zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.	MTKRS, MMPAU, MPPTT në bashkëpunim me njesitë e qeverisjes vendore.	Vendim i Këshillit të Ministrave	Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	b. Përgatitje e materialit dhe miratimi me Vendim i zonave/vendbanimeve informale dhe territoreve të tjera të zëna, rast pas rasti.			Sipas afate që përcakton VKM
	c. Ndjekje të procedurave të vetëdeklarimit dhe legalizimit për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, të miratuara për legalizim me VKM.			Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	ç. Identifikimi i territoreve të zëna nga ndërtimet pa leje, në zona të ndotura apo problematike për shkak të ndotjes mjedisore.	MMPAU, e Këshillat e Qarqeve	Vendim i Këshillit të Ministrave	30 ditë nga mbanimi i afatit të vetëdeklarimit.
	d. Paraqitje e propozimit për pezullim të procedurave të legalizimit dhe miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave, rast pas rasti.			Menjehere me miratimin e propozimit për pezullim legalizimi në Qarqe
	e. Hartimi i strategjive për eliminimin e ndotjeve në zonat me ndërtime pa leje, me afate konkrete, zbatimi dhe miratimi i tyre njëkohësisht me miratimin e propozimit për pezullimin e procedurave të legalizimit.	MMPAU, MPPTT e njësi vendore	Dokumentacioni përkatës	

6. Përmirësime dhe rregullime të fushave të veçanta, që interferojnë me implementimin e ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	f. Zbatimi i strategjisë për eliminimin e ndotjeve, e rifillim procedurash legalizimi			sipas afateve konkrete të VKM.
	g. Marrja e masave të posaçme për parandalimin e ndërtimit në zonat e ndotura dhe - identifikimin dhe rregjistrimin e banorëve. - identifikim i ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura, nga ligji 8906, datë 06.06.2002.	MB, MIMPAU ALUIZNI, Policia ndërtimore dhe kryetari i njësisë vendore	Listat përkatëse	Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e VKM për pezullim procedurash dhe në vijim.
	a. Evidentimi i subjekteve, pronat e të cilëve janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, që do të dërgohen KM për shpërblimin në natyrë ose lekë.	ZQRRPP e ALUIZNI	Listat përkatëse	Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e dhe çdo tre muaj në vijim.
	b. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për shpërblimin e pronarëve dhe pjesën takuese" sipas listës së paraqitur nga ZQRRPP, rast pas rasti.	MD, ZQRRPP MBUMK, KSHKKP,		30 ditë pas depozitimit të listës.
	c. Hartimi dhe miratimi i amendimeve në ligjin 7843 "Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme" apo të akteve nënligjore në funksion të përcaktimeve të bëra në ligjin "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	MD, ZQRRPP e MBUMK	Vendim i Keshillit të Ministrave	1 vit nga hyrja në fuqi e ligjit.
	ç. Hartimi dhe miratimi i amendimeve në ligjin 8408 "Për policinë e ndërtimit" apo të akteve nënligjore në funksion të përcaktimeve të bëra në ligjin "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	MPPTT e Policia e Ndërtimit		
	d. Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri të urbanistikës.	MPPTT	Parlamenti Shqiptar	Brenda janarit të vitet 2007
	e. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për kriteret dhe procedurat e bashkëveprimit të punës midis institucioneve përkatëse për identifikimin e subjekteve që janë njëkohësisht subjekt i zbatimit të ligjit për legalizimin dhe i ligjit për kthim kompensimin e pronës".	MD, KSHKKP, ZQRRPP	Vendim i Keshillit të Ministrave	Brenda 10 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
	a. Përgatitja e një udhëzuesi "Për mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të përfuara nga ligji "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	MF & MPPTT		
	b. Përgatitja e një dokumenti të tarifave të shërbimit që do të aplikojë njësi vendore gjatë procesit të vetëdeklarimit dhe legalizimit.	MF, MPPTT & ALUIZNI MD, MPPTT	Udhëzues i përbashkët	Brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	c. Përgatitja të përmbajtjes dhe formës së deklaratave të përgjegjësisë për defektet e banesës, të zbatimit të planit rregullues, të heqjes dorë nga ushtrimi i të drejtës për legalizimin, të ndarjes së pjesëve takuese etj	ALUIZNI		

7. Mënjanimi i keqinterpretimeve, unifikimi i procedurave dhe veprimet konkrete për implementimin e ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	ç. Identifikimi, pranimi i dokumentacionit, shqyrtimi dhe miratimi i boniteteve të tokave bujqësore si dhe pasqyrimi i vendimeve të KRRTRSH/KRRT në fondet e tokës bujqësore.	MBUMK& MPPTT	Dokument përkatës	Deri në përfundim të procesit të vetëdeklarimit.
	d. Përmbytja e deklaratës së investitorit për kalimin në pronësi të sipërfaqes së strehimit të familjes së pastrehë dhe mënyra e regjistrimit në ZRRPP.	MD e ZQRRPP		
	dh. Evidentim i situatës dhe i numrit të subjekteve në pamundësi financiare për pagesat e legalizimit.	ALUIZNI		
	e. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Për përcaktimin e mënyrave alternative dhe procedurave për shlyrjen e detyrimit financiar për subjektet në pamundësi financiare.	MF, MPPTT & ALUIZNI	Vendim i Këshillit të Ministrave	30 ditë nga mbarimi i afatit të vetëdeklarimit.
	ë. Mënyra e veprimit për rastet e ndërtimeve pa leje në zona ku plani i përgjithshëm rregullues parashikon ndërtime mbi 5 kate nga niveli ±00 dhe mënyra e zbatimit të saj.	MPPTT, Policia e ndërtimit & ALUIZNI		Ne fund të vitit 2006
	f. Modalitetet e kontratës së bashkëfinancimit dhe kontrollit për urbanizimin e zonës/vendbanimit informal ndërmjet komunitetit dhe njësisë vendore.	MPPTT, ALUIZNI MF	Dokument përkatës	Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
	g. Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e territorit të zonës/vendbanimit informal të miratuar dhe prioritetet në trajtim" menjëherë pas miratimit nga KRRTRSH, rast pas rasti.	MPPTT, ALUIZNI MB	Vendim i Këshillit të Ministrave	Pas mbarimi të afatit të vetëdeklarimit e në vijim.
	gj. Përgatitja e materiali të inventarit të zonave dhe monumenteve të kulturës, në fuzion të zbatimit të ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".	Istituti i Monumenteve të Kulturës	Dokument përkatës	Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit
	h. Publikimi në buletinë të njoftimeve dhe dërgimi në zyrat e ALUIZNI dhe njësitë e qeverisjes vendore të materialit të inventarit të zonave dhe monumenteve të kulturës.	IMK ALUIZNI		15 ditë pas marjes së njoftimit
	i. Marrja e masave të posaçme për vendosjen e kontrollit mbi territorin e këtyre zonave.	Policia e Ndërtimit me	Njoftimi përkatës	Vazhdimisht

VENDIM
Nr.398, datë 21.6.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.560, DATË 12.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË UNIVERSITETET DHE
SHKOLLAT E LARTA PËR VITIN AKADEMIK 2005-2006, NË SISTEMIN ME KOHË TË
PLOTË, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR KËTË VIT
AKADEMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 11 të vendimit nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Studentët (gjithsej 14) e ardhur me kuota të ndërmjetme, për të vazhduar studimet në vitin e dytë, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, sipas marrëveshjes së 8 janarit, të nënshkruar në Ohër të Maqedonisë, dhe aneksmarrëveshjes së datës 2 qershor, të nënshkruar në Tiranë, do t’i nënshtrohen tarifës së studimit sipas kuotës kryesore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS

MARRËVESHJE

MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS SË REPUBLIKES SË MAQEDONISË

Në kuadër të nismave për bashkëpunim rajonal dhe të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit në fushën e arsimit ishte edhe Marrëveshja e lidhur me 8 janar 2005, në Ohër të Republikës së Maqedonisë, e cila kishte të bënte me zgjidhjen e problemit lidhur me studentët e ish-Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës.

1. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët nënshkruese ranë dakord që, për zgjidhjen e problemit, të marrin përgjegjësi konkrete tre Universitetet shtetërore (i Prishtinës, i Tiranës dhe i Shkupit).

2. Në funksion të kësaj, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë ranë dakord që marrëveshja të ketë edhe disa shtesa, dhe konkretisht:

a) Numri i studentëve të parashikuar në vitin akademik 2004-2005 të jetë nga 46 në 57 (numri i kuotave të pranimit).

b) Numri i studentëve të parashikuar sipas pikës 4, të marrëveshjes së 8 janarit 2005, në Ohër “Në Universitetin e Tiranës 10 studentë”, të zëvendësohet me tekstin “Në Universitetin e Tiranës 14 studentë”. Bëhet fjalë për studentët që do të vijnë në vitin akademik 2005-2006 në vitin e dytë të studimit.

3. Meqenëse në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes, shteti Shqiptar nuk aplikonte tarifë shkollimi për kuotat e ndërmjetme dhe grupi i parë i studentëve të ardhur nuk i janë nënshtruar kësaj

1904

tarife, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, angazhohet për të kryer të gjitha procedurat për përjashtimin e këtyre studentëve nga tarifa e shkollimit.

4. Ministri i Arsimit dhe Shkencës i Shqipërise zoti Genc Pollo, angazhohet për zbatimin e këtij aneksi marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 2 qershor 2006.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Genc Pollo

Aziz Polozhani

VENDIM
Nr.399, datë 21.6.2006

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

2. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

3. Pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

4. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 20 për qind.

5. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 20 për qind.

6. Rritje pensioni përfitojnë:

a) Pensionet e përmendura në pikat 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht, që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

b) Pensionet e përmendura në pikat 4 e 5 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që

caktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet që caktohen në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 240 (tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë në muaj dhe jo më shumë se 16 480 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

8. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 4 110 (katër mijë e njëqind e dhjetë) lekë në muaj.

9. Rritja e pensioneve, të parashikuara nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

10. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994, rriten në masën 5 për qind.

11. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 1 470 milionë lekë, të përballohen nga:

- Fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. 927 milionë lekë.

- Fondi i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006” 543 milionë lekë.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.400, datë 21.6.2006

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT
VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 1906

11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1 Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 2005	1.00;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;
Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, e që janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2006, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.374, datë 31.5.2005 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.401, datë 21.6.2006

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jenë më pak se 9 240 (nëntë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të pensionistit, përfshijnë masën e pensionit të pleqërisë, kompensimin, që jepet sipas vendimeve nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse” dhe nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufijtë e pikës 1, të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione, të plota dhe të pjesshme, pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nga 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë deri në 9 239 (nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë, t’u shtohet shuma fikse individuale deri në 500 (pesëqind) lekë në muaj.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të ardhura mujore nën 8 740 (tetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, t’u shtohet shuma fikse 500 (pesëqind) lekë në muaj.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të shkronjave “a” e “b” të pikës 2, të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët, që datën e fillimit të pensionit e kanë në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, përfshirë edhe këtë datë.

5. Kompensimet e përfituara sipas këtij vendimi nuk do të jenë objekt ndryshimi, në rastet e rritjes së pensioneve, me vendime të Këshillit të Ministrave.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 110 milionë lekë, të përballohen nga fond i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”.

7. Shpenzimet administrative për realizimin e këtij vendimi, që arrijnë vlerën 7.6 milionë lekë, të shtohen: në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ISSH-në dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, të caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin Shtetit të vitit 2006”.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.11.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.402 datë 21.6.2006

PËR SHPALLJEN E EKOSISTEMIT NATYROR TË MALIT TË DAJTIT “PARK KOMBËTAR” (ME SIPËRFAQE TË ZGJERUAR)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “b”, 6 e 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror të malit të Dajtit “Park kombëtar”, (me sipërfaqe të
1908

zgjeruar), sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e këtij parku kombëtar të ndryshojnë, si më poshtë vijon:

a) Në Veri — Kufiri administrativ, ndërmjet rrethit të Krujës dhe të Tiranës, kuota 794m (Maja e Fraveshit) (41°32'11'' V dhe 19°47' 48 L), vijon me kuotat 1 090 m, 1 227 m (Maja e Zithit) deri te kuota 1 627 m (41°31' 52'' V dhe 19°54' 44'' L);

b) Në Lindje — Kuota 1 627 m (41°31'52'' V dhe 19°54'44'' L), ndjek kurrizin e vargmalit Xibër-Mali me Gropa, me kuotat 1 473 m (Maja e Repës), 1 388 m, 1 295 m, 1 613 m (Maja e Popatit), 1 455 m (Maja e Stravecit), 1 594 m, 1 700 m, 1 827 m (Maja e M.Shënbërisë), 1 71 m, 1 498 m, deri te ndërprerja me rrugën automobilistike Tiranë-Bizë, në afërsi të fshatit Burimas, dhe rrjedhjen e lumit Erzen (41°20'29'' V dhe 20°09' 56'' L);

c) Në Jug — Rrjedhja e lumit Erzen (41°20'29 V dhe 20°09'56 L), rezervuari i Skoranës deri te Gryka e Skoranës (41°15' 26'' V dhe 19°57' 37'' L).

ç) Në Perëndim — Gryka e Skoranës (41°15' 26 V dhe 19°57' 37' L), dhe vijon me kuotat 890m (Maja e Kuorës), pranë fshatit Përçellesh, në Priskën e Madhe, vazhdon me rrugën automobilistike Priskë-Surrel, ndjek rrugën automobilistike Surrel-Tiranë, deri në afërsi të komunës së Dajtit, më pas në kuotat 573m (Maja e Qytezës), 445m (Maja e Shpatës), në afërsi të fshatit Brar dhe Priskë e Vogël, ndërpret lumin e Tërkuzës, kuotat 1 268m (Maja e Gamtitit) deri te kuota 794 m (Maja e Fraveshit) (41°32' 11 V dhe 19°47' 48'' L).

3. Parku Kombëtar i malit të Dajtit ka me një sipërfaqe prej 29 384, 18 ha, ku përfshihen:

a) Sipërfaqe pyjore e shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore	20 410, 75 ha;
b) Sipërfaqe kullosore, livadhe dhe bimësi barishtore	1 891, 63 ha;
c) Sipërfaqe bujqësore, pemëtore, ullishta e vreshta	4 169, 03 ha;
ç) Sipërfaqe ujore dhe rezervuarë	38 1,35 ha;
d) Sipërfaqe joproduuese, shkëmbore, gurore, e zhveshur, miniera	2 470,3 0 ha;
dh) Sipërfaqe urbane, troje të përziera me tokë bujqësore	6 1,12 ha.

4. Parku Kombëtar i malit të Dajtit ndahet në zona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zonë qendrore, (e shënuar në hartë me “ZQ”, me sipërfaqe 9 101, 23ha) dhe që përfshin nënndarjet:

- a/1. Zonë në ruajtje të veçantë, (e shënuar në hartë me “ZQ₁”)
- a/2. Zonë mjedisore natyrore, (e shënuar në hartë me “ZQ₂”)
- a/3. Zonë me monumente natyrore, (e shënuar në hartë me “ZQ₃”)

Ato përcaktohen si zona me vlera për natyrën dhe biodiversitetin dhe përfshijnë habitatet në malin e Dajtit, malin e Priskës, Brarit dhe Fekenit. Në zonën qendrore zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.

b) Zonë rekreative, (e shënuar në hartë me “ZR”, me sipërfaqe 2 365, 13 ha) dhe që përfshin nëndarjet:

- b/i. Zonë rekreative aktive (e shënuar në hartë me “ZR₁”)
- b/2. Zonë rekreative natyrore (e shënuar në hartë me “ZR₂”)

Ato përbëjnë zonën me mundësi rekreative në natyrë të hapur dhe me lehtësira, që respektojnë funksionet e parkut, vlerat ekologjike, të peizazhit natyror dhe vlerat turistike e kulturore. Në zonën rekreative zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

c) Zona e përdorimit tradicional (e shënuar në hartë me “ZPT”, me sipërfaqe 16 602, 22 ha), e cila mundëson vazhdimin e veprimtarive tradicionale. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e kartë e mbrojtjes.

ç) Zonë e përdorimit të qëndrueshëm, (e shënuar në hartë me “ZPQ” sipërfaqe 1184, 27 ha), në të cilën lejohen veprimtaritë ekonomike ekzistuese, me “ZPU”, si dhe mund të hapen veprimtari të reja, vetëm pas pajisjes me lejen përkatëse. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e

pestë e mbrojtjes.

d) Zonë e përdorimit ushtarak, (e shënuar në hartë me “ZPU” sipërfaqe 131, 33 ha), e cila përdoret për qëllime ushtarake ose për rezidenca qeveritare.


5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-shkencore dhe me përfaqësuesit e biznesit e të pronarëve private, të marrin masa për të siguruar zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ministritë e tjera të linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore, të rishikojnë lejet e dhëna për veprimtari, ekonomike e shoqërore, brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar. Subjektet e pajisura me lejet përkatëse do të vazhdojnë ta ushtrojnë këtë veprimtari nëse nga pikëpamja ligjore përmbushin kriteret e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, si dhe kur janë në përputhje me synimet dhe objektivat e menaxhimit të parkut.

7. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.403, datë 14.6.2006

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1 të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Lidhja I, “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ii) Lidhja nr.2, “Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore dhe institucioneve qendrore”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2 të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Lidhja II, “Paga bazë sipas klasave”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ii) Lidhja II/M, “Paga bazë për punonjësit e ministrave, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, zëvendësohet me lidhjen II/M, “Paga bazë për punonjësit e ministrave, institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

iii) Lidhja II-5, “Paga bazë për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore”, zëvendësohet me lidhjen II-5, “Paga bazë për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në pikën 12, vlera “...310 lekë...” zëvendësohet me “...350 lekë.

c) Në pikën 13, vlera “... 180 lekë . . .“ zëvendësohet me “... 250 lekë.

d) Në pikën 17, vlerat “...310 lekë, 180 lekë dhe 150 lekë...” zëvendësohen, përkatësisht, me “... 350 lekë, 250 lekë dhe 210 lekë...”.

dh) Në lidhjen II-A, kreu II, “Shtesa të tjera”, në pikën 16, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kameramani/fotografi i Kryeministrit përfiton një shtesë, për natyrë të veçantë pune, në masën 30 (tridhjetë) për qind mbi pagën bazë mujore.”.

e) Në lidhjen II-4, “Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave”, në pjesën e dytë, në numrin rendor 3, pas emërtesës “... Magazinier...” shtohet emërtesa “Kameraman/fotograf”, me pagë sipas klasës IX (nëntë).

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1

RENDITJA E FUNKSIONEVE SIPAS KLASIFIKIMIT

A1		170260
A2	Kryetar i Akademisë së Shkencave	162850
A3	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave	127000
A4		122500
A5		114850
A6	Akademik	107160
A7	Kancelar i Gjykatës së Lartë Sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme	99560
A8	Profesor në universitete e shkolla të tjera të larta dhe në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave.	91850
A9		84250
A10	Shef i Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm	81430
All	Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Profesor i asociuar në universitete e shkolla të tjera të larta dhe në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave.	79690
A12	Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm. Drejtor Drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme.	78060
B1		71980
B2	Profesor në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Lektor. Punonjës kërkimor në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave	68940
B3	Profesor i asociuar në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Kryeinspektor i policisë së bashkisë së Tiranës. Pedagog. Kërkues në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave. Rektor (pa titull/gradë shkencore)	58190
B4	Përgjegjës sektori në Gjykatën e Lartë. Përgjegjës sektori në Prokurorinë e Përgjithshme. Asistent në shkollat e larta. Asistent në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave.	47500
B5	Punonjës kërkimor në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Inspektor i policisë së bashkisë së Tiranës. Zëdhënës i Prokurorit të Përgjithshëm. Përgjegjës zyre në Prokurorinë e Përgjithshme. Inspektor kontrolli në Prokurorinë e Përgjithshme. Përkthyes në Prokurorinë e Përgjithshme	39840
C1		39840
C2	Kërkues në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Specialist në Gjykatën e Lartë. Sekretar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Specialist, Jurist në Prokurorinë e Përgjithshme. Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm. Informaticien në Gjykatat e shkallës së parë dhe në Gjykatat e Apelit.	35230
C3	Asistent në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Sekretar i Kancelarit të Gjykatës së Lartë	30620

Lidhja nr.2

KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË LARTË
SHTETËRORE DHE INSTITUCIONEVE QENDRORE

A1	170260
A2	162850
A3	127000
A4	122500
A5	114850
A6	107160
A7	99560
A8	91850
A9	84250
A10	81430
A11	79690
A12	78060
B1	71980
B2	68940
B3	58190
B4	47500
B5,C1	39840
C2	35230
C3	30620

LIDHJA II

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE

Nr.rendor	Klasa	Paga baze mujore në lekë
1	I	14000
2	II	14300
3	III	14600
4	IV	14900
5	V	15200
6	VI	15500
7	VII	15800
8	VIII	16100
9	IX	16675
10	X	17250
11	XI	18400
12	XII	19550
13	XIII	21850
14	XIV	26450

LIDHJA II/M

PAGA BAZË PËR PUNONJESIT E MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE TE TJERA QENDRORE
DHE PREFEKTURAVE

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	14000
2	II	14300
3	III	14600
4	IV	14950
5	V	16100
6	VI	17250
7	VII	19550
8	VIII	21850
9	IX	24150
10	X	29325

Lidhja II-5

NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË TJERA QENDRORE DHE PREFEKTURAVE

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i Pagës Klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1	Sekretari Komisionit te Kualifikimit		
	Shkencor	X	6
	Kryesekretar i Shkollës së Magjistraturës	X	
	Shef sektori	IX	5
	Kryetar dege		
	Përgjegjës zyre	IX	3
	Specialist i parë	VII	
	Inspektor i parë		
	Specialist i dytë	VII	
	Inspektor i dytë		
	Sekretar i titullareve të tjerë		
	Arkivist.Protokollist	VI- VII	
	Kryellogaritar		
	Përgjegjës administrate	VI	1
	Sekretar i Zv/Prokurorit të Përgjithshëm.	VI	
	Llogaritar i I-rë.		
	Përkthyes	VI	
	Shifrant (MPJ)		
	Përgjegjës ofiçine e transporti	V	
	Operator i terminaleve		
	Llogaritar		
	Shofer	IV	
	Magazinier		
	Daktilografist		
	Shaptilografiste		
	Fotokopjuese		
	Arkëtar		
	Korrier diplomatik. (MPJ)		
	Shpërndarës shifre. (MPJ)		
	Spedicioner. (MPJ)		

Punëtor	II-IV
Nëpunës informacioni	II
Portier. Pastrues. Korrier	
Kafaz i salloneve të pritjes (MPJ)	I

VENDIM
Nr.404, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 20 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1, “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 4, lidhja nr.3, “Funksionet ushtarake, që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme, në shëndet, në strukturat e Forcave të Armatosura”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 4/1 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA BAZË SIPAS GRADEË DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA
Oficerë

Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj.Lejtnant (Admiral)															141400
Gj.Major (Nënadmiral)														132500	135100
Gj.Brigade (Kundëradmiral)													102700	104700	104700
Kolonel (Kapiten i rangut I-rë)											75650	77150	78800	80400	82000
Nënkolonel (Kapiten i rangut II-të)									56200	57300	58400	59600	60800	62000	63200
Major (Kapiten rangut III-të)							41700	42500	43350	44200	45100	46000	46860		
Kapiten (Kapiten lejtnant)				35000	35600	36200	36800	37400	37700	38000	38300				
Toger (Lejtnant)			33500	34000	34400	34700	35000								
Nëntoger (Nënlejtnant)	30500	31000	31500	32000	32500	32500									

Nënoficerë

Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											39000	39500	40500	41000	42000
Kapter								32000	33000	34100	35200	36500	37500		
Rreshter						29000	30000	31000	32000	33000	33600				
Tetar				26000	27500	27500	28000	28500	29000	29500	30000				
Nëntetar	22600	23000	23500	24500	26500	26500									

Ushtarë profesionistë

Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/detar profesionist II	22 500	22900	23400	24400	26500										
Ushtar/detar profesionist I	21000	22000													

Ushtarë të shërbimit të detyrueshëm e studentë ushtarak

Vitet e shërbimit															
	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/Detar II	1500														
Ushtar rekrut /Detar I	1000														
Student ushtarak	1000														

FUNKSIONET USHTARAKE QË PËRFITOJNË SHITESË PËR PUNË TË VËSHTIRË E TË DËMSHME NË SHËNDET NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës në lekë
1	Në laboratorin e municioneve të Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit. Shef i seksionit. Teknolog kimist. Teknik me specialitete të ndryshme.	7400
2	Në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit. Shef i seksionit. Specialist analizash. Specialist për sintezën. Teknolog kimist. Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek anatomopatolog.	5900
3	Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek neurokirurg. Teknik për higjienën e ujit. Teknik për higjienën ushqimore. Inxhinjer kimist. Mjek i Laboratorit klinik biokimik. Kryelaborant klinik biokimik. Laborant klinik biokimik. Mjek histolog. Laborant histolog. Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Ushtarakët në sektorin e rigjenerimit të karburanteve.	5200
4	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Teknik rendues. Ushtarakët që punojnë në rrjetet kompjuterike LAN/WAN. Ushtarakët në pikat e ritransmetimit, radiozbulimit dhe pikat e vrojtimit të qendëruara. Inxhinier elektronik. Informaticien. Në Forcat Ajrore: Asistent kontrollor trafiku ajror. Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Ushtarakët në sektorin e riparimit të radiollokacionit, në sektorin e frekuencës së ulët dhe të lartë. Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek i higjienës ushtarake dhe inspektor sanitar. Mjek toksikolog. Mjek neuropsikiatër. Kryeinfermier në shërbimin e neuropsikiatrisë. Mjek anesteziist reanimator. Ndihmësanesteziist. Kryeinfermier reanimacioni. Kryeinfermier dhe infermiere të sallave të operacionit, të urgjencës dhe të reanimacionit kirurgjikal. Teknik për DDD (Dizinfektim, Deratizim, Dezinsektim). Prozektor. Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Në seksionin e analizave kimike në laboratorin e analizave kimike: Specialist i teknikës e aparaturës. Specialist ventilimi. Shofer mjeteve speciale. Në seksionin e intendencës në laboratorin bakteriolog: Shef i seksionit. Teknolog kimist. Biokimist. Në seksionin e mjeteve të indikimit në laboratorin e analizave kimike: Specialist për teknikën e aparaturës. Specialist përpunim qelqi. Në laboratorin e analizave kimike: Magazinier. Në laboratorin e municioneve: Teknik/shofer	4400
5	Në të gjithë strukturat e Forcave të Armatosura: Magazinier/Nënoficer furnizimi që merret me karburante. Pilot avioni. Pilot helikopteri Polumbar (zhytësa). Në strukturat xheniere: Manovrator dhe ndihmësmannovrator makinerive të rënda (buldozer, eskavator, rulist, motorulist, vinçier, autovinçier, etj). Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek radiolog. Mjek depistim radiologjik. Mjek pneumolog. Laborant teknik në shërbimin radiologjisë. Oksigjenist. Elektracist. Specialist mirëmbajtës, pajisjeve mjekësore.	3700

	Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Drejtori. Zv.drejtori Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Ushtarakë në repartin a furnizimit (me karburante speciale). Në Batalionin e Ndërlidhjes të Shtabit të Përgjithshëm: Teknik kabllist i rrjetit të jashtëm. Radist. Radiorelist Operator. Specialist SUE (stacioni i ushqimit elektrik)	
6	Në strukturat xheniere: Motokompresorist. Pistoletist. Ndhmës motokompresorist. Ndhmëspistoletist. Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek fizioterapeut. Mjek hematolog. Mjek, kryeinfermier e infermier në shërbimin e urgjencës dhe të pranimit. Mjek infeksionist. Mjek reanimacioni terapisë. Mjek epidemiolog. Teknikien i mjekësisë Forcave Ajrore (Aviacionit). Teknikien i mjekësisë Forcave Detare (Marinës). Masazhist në fizioterapi. Në Forcat Detare: Shef stacioni akustik, instruktor, laborant navigacioni. Radiometrist. Mirëmbajtës kuvertash. Nënoficer i planshetës operate. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Komandanti batalionit. Zv.komandanti i batalionit. Shef zbulimi i batalionit. Shef/Oficer shtabi operacional batalionit. Specialist mirëmbajtje radar në batalion. Specialist mirëmbajtje radar në qendrat e vëzhgimit ajror. Shef i qendrës vëzhgimit ajror. Zv.Shef i qendrës vëzhgimit ajror. Komandant radari Shef seksioni i përpunimit të të dhënave. Nënoficer i kontrollit të ekranit RD (radarit). Nënoficer i përpunimit transmetim informacionit. Nënoficer i teknikës speciale. Teknik mirëmbajtje radar. Ushtarakë në Qendrën Operacionale të Vëzhgimit Ajror. Në Qendrën Operacionale të Sovranitetit Ajror: Shefi i Qendrës Operacionale të Sovranitetit Ajror. Shef i seksionit të drejtimit. Specialist ndërlidhje. Specialist kontrolli trafikut ajror. Specialist për mbrojtjen ajrore. Në brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Ushtarakët në seksionin e rikontrollit të raketave, në repartet e M-A.	3000
7	Në të gjithë strukturat e Forcave të Armatosura: Të gjithë funksionet organike, në përbërje të të cilave është dhe emertimi "operator". Teknik kablist i rrjetit të brendshëm. Kabllist. Specialist i linjave telefonike. Kryeoperator. Baterist. Saldator oksigjenist. Laborant kimist. Specialist laborant kimist. Shofer autoboti karburanti. Elektracist. Telefonist i qendrës së ndërlidhjes. Ushtarakët e kompanive (qendrave të ndërlidhjes që punojnë në tunele. Shef radiostacioni. Elektroaut baterist. Elektroakumulorist. Radist. Centralist. Nënoficer i radios. Radiorelist. Radiometrist. Magazinier i lëndëve helmuese luftarake. Shef PVQ (pikë vrojtimi qendror). Specialist riparimi/mirëmbajtje të mjeteve kompjuterike. Specialist i administrimit të rrjeteve kompjuterike. Në Forcat Tokësore: Instruktor teknike (tanke) Në Forcat Ajrore: Specialist për vlerësim me mjete radioteknike, Ushtarakët në shërbimin meteorologjik. Ushtarakët e mirëmbajtjes në skuadriljet dhe në qendrat e mirëmbajtjes. Shef zbulimi në komandën e shtabin e forcës. Në sektorin e kontroll kolaudimit në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shofer/mekanik Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Mjek specialist në specialitet e terapisë. Mjek kirurg në specialitetet e kirurgjisë. Mjek mikrobiolog.	2200

	Mjek higjienist dietolog. Mjek në poliklinikë. Mjek stomatolog. Kirurg maxilofac. Otorinolaringolog. Okulist. Mjek ortoped traumatolog. Kryeinfermier. Kryeinfermier i përgjithshëm. Infermier. Farmacist. Laborant në shërbimin e mikrobiologjisë. Ushtarakët në Orkestrën Frymore të Forcave të armatosura. Në strukturat xheniere: Specialist duralumini. Agregatist. Në Forcat Detare: Oficer shtabi për llokacion. Specialist analize, informacioni sigurisë. Specialist llokacioni, analize, informacioni, siguri. Nënoficer i mirëmbajtjes vëzhgimit detar. Shef ndërlidhje llokacioni. Specialist/operator llokacioni. Komandant, Zv.komandant, Shef organi në anije. Teknik riparues llokacioni. Komandant skuadre llokacioni. Radist Radiometrist. Specialist SUE (stacion ushqimit elektrik). Komandant i kompanisë vëzhgimit detar. Komandant PRT (poste radioteknike). Nënoficer analize, informacioni. Motorist. Kryemotorist. Përgjegjës kuverte. Mitralier në anije. Infermier në anijen polumbare. Hambarist, Elektricist, Kaldaist, Kuzhinier në anije. Ushtarakë në dokun lundrues të kantierit i riparimit anijeve. Në Arkivin Qendror: Arkivist. Shef i laboratorit të mikrofilmit. Në Shërbimin Informativ Ushtarak: Ushtarakë në zyrën e mbështetjes teknike. Në qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror: Komandant qendre mirëmbajtje. Zv.Komandant qendre mirëmbajtje. Specialist radio e pajisjeve speciale. Shef seksioni shfrytëzimi. Shef seksioni specialiteteve. Shef seksioni mirëmbajtje. Nënoficer shfrytëzimi. Nënoficer pajisjeve Speciale Radio Armatime. Kompania e riparimeve në batalionin logjistik të Forcave Ajrore: Komandant i kompanisë. Shef i seksionit riparim armatimit. Shef seksionit riparim auto. Shef i seksionit riparimit radar ndërlidhje. Specialist për SDT (stacion drejtimi topave), ADZAKA (aparati i drejtimit zjarrit artilerisë kundër ajrore), RDKA (raketa drejtimit kundërajror), ISPIL (instrumente të lëvizshme të raketave). Shef i seksionit rigjenerimit karburantit special. Laborant i analizave karburantit special. Laborant karburanti special avioni. Në qendrën stacionare të ndërlidhjes të Batationit të Ndërlidhjes së Shtabit të Përgjithshëm: Komandanti. Zëvendëskomandanti. Nënoficer për furnizimin. Specialist teknik. Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Oficer shtabi MADM (mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë) Oficer shtabi teknikës speciale. Shef i qendrës riparimit. Nënoficer stacioni dhënës marrës. Nënoficer stacioni KSPK (kabina e koordinatave të sistemit të përpunimit të komandave). Specialist për instrumente matës. Shef i sektorit riparim kontroll raketa. Nënoficer SKEL (stacion kontroll elektrik i raketave) R/D (radar) autopilot. Kryeoperator SKEL (stacion kontrolli elektrik i raketave) autopilot. Operator (kontroll raketa). Teknik linje. Komandant batalioni RDKA (raketat e drejtuara kundërajrore). Zv.komandant, shef shtabi, Shef operacioneve e stervitjes batalioni RDKA (raketat e drejtuara kundërajrore). Shef i zbulimit teknikës speciale në batalion RDKA (raketat e drejtuara kundërajrore) Komandant i baterisë Radioteknike, Shef KIT (kryetchnik) kabinës dhënëse marrëse. Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Kryeoperator kabinës dhënëse marrëse. Operator i kabinës dhënëse marrëse. K/T (kryetchnik) kabine RDHK (radiodhënësi i komandave). Kryeoperator kabine RDHK (radiodhënësi i komandave) Shef K/T (kryetchnik) i kabinës I. Operator i kabinës I. Kryeoperator i kabinës I. Kryetchnik kabine koordinative. Kryeoperator kabine koordinative. Kryetchnik i kabinës SPK (sistemi i përpunimit të komandave). Kryeoperator i kabinës SPK (sistemi i përpunimit të	
--	--	--

	komandave). Kom. Kryeteknik kabine SH. Specialist stacioni elektrik. Kryeoperator i kabinës DSHL (drejtimi i shtratit të lëshimit). Në Bazën e Riparimit të Aviacionit: Specialist në sektorin e kontrollit të cilësisë e laboratorit. Shef i kontrollit mekanik dhe sigurimit teknik. Shef /specialist mekanik Shef /specialist percinues. Shef i riparimit agregateve hidraulike Shef/specialist i riparimeve elektrike. Shef specialist riparim motori. Shef /specialist prodhimi, tornitor. Shef specialist galvanizimi. Shef/specialist riparimi elektrogazi. Në Qendrën e Radiozbulimit: Operator radiozbulues. Në Institutin Gjeografik: Specialist topogjeodet. Ushtarakë në seksionin e laboratorit dhe shtypit. Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Shofer autoambulance. Shef karrofiçine. Fotograf. Bojaxhi. Marangoz. Specialist druri. Specialist duralumin. Veteriner. Specialist mirëmbajtje (mekanik, tornitor, kovaç, motorist, frezator, xhenerik, hekurkthyes, ribatinist) Specialist/nënoficer mbrojtjes kundër kimike/ MADM. Specialist në kartotekë. Telefonist i qendrës ndërlidhjes. Shef shëndetësie. Mjek. Farmacist. Ndihmësfarmacist. Ndihmësmjek. Infermier. Kryeinfermier. Arkivist. Specialist arkivi. Shef i sekretarisë, shifrës dhe arkivit. Shef i sektorit të administrimit të dokumenteve. Ushtarak në sektorin e evidencës (kartotekës) në Shtabin e Përgjithshëm. Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar: Teknicien i përgatitjes edukimit shëndetësor. Magazinier. Nënoficer furnizimi. Në të gjitha strukturat xheniere: Hekurkthyes. Ndihmës hekurkthyes. Në qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror: Specialist elektrogazi dhe furnizimi. Specialist shfrytëzimi. Nënoficer shfrytëzimi. Specialist radio. Specialist armatimi. Specialist i pajimeve speciale.	
8	Në Brigadën e Mbrojtjes Ajrore: Specialist SHL (shtrat lëshimi). Shef seksioni rigjenerim karburantit, Nënoficer riparimi aparaturave furnizimit me ajër. Teknik MTM (makina transporti mbushëse). Teknolog rigjenerues. Komandant i baterisë teknike. Shef i repartit furnizimit. Kryeteknik AFO (aparaturë furnizimi oksidues)/ AFK (aparatur furnizimi karburanti) AN (aparatur neutralizimi). Kryeteknik kompanie. Kryeteknik AFA (aparaturë furnizimi me azot). Numëror AFO (aparaturë furnizimi oksidues) AFK (aparatur furnizimi karburanti). Kryeteknik kompresori. Numëror kompresori. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Mekanik. Specialist auto. Nënoficer për riparimin e teknikës. Komandant i skuadrës së transportit e mirëmbajtjes. Specialist mirëmbajtje. Në Forcat Detare: Komanda e shtabi i flotiljeve. Komanda e grupeve lundruese. Në Shtabin e Distriktit Detar: Komandant. Zv.komandant. Shef shtabi. Shef operacioneve. Shef zbulimi. Shef ndërlidhje. Specialist lundrimi. Ushtarakë të tjerë në Qendrën e Bashkuar Operacionale. Në Qendrën Kulturore të Forcave të Armatosura: Ushtarakë në grupin artistik.	1500
9	Në të gjithë strukturat e Forcave të Armatosura: Saldator me elektrik. Kryekuzhinier. Kuzhinier. Kaldaist. Specialist mirëmbajtje (gomist, saldator, axhustator, grasatorist, lavazhier, hidraulik)	800

Shënim.

Ushtarakët, funksioni i të cilëve përmban dy apo më shumë emërtime që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet, do të trajtohen vetëm me një shtesë sipas kësaj lidhje.

Shefat e shërbimit/reparteve, drejtori, zv.drejtori në SUQU përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet sipas specialitetit.

VENDIM
Nr.405, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon.

“3. a) Paga e drejtorit të Policisë së Ndërtimit njësohet me pagën e nëpunësit civil, të kategorisë II-a, në ministri, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. b) Paga e zëvendës drejtorit të Policisë së Ndërtimit njësohet me pagën e nëpunësit civil, të kategorisë II-b, në ministri, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar.

3. c) Tabelat nr.2, “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit, në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit, në rrethe”, zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

- Në fund të pikës 4, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Drejtori dhe zëvendës drejtori i Policisë së Ndërtimit nuk përfitojnë shtesë page për natyrë të veçantë pune dhe shtesë page për vështirësi shërbimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Tabela nr.2

PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË
QENDËR

Nr.	Emërtimi	Klasa	Paga në lekë
1	Drejtor		II-a
2	Zëvendës drejtor		II-b
3	Kryetar dege	XXII	33600
4	Shëf sektori	XXII	33600
5	Kryetar Grupi Gatishmërie	XXII	33600
6	Specialistë	XXI	31200
7	Shofer	IX	18960
8	Punonjës Grupi Gatishmërie	XIX	26160
9	Arkivist.Daktilografist.Protokollist	VI	16680

10	Magaznier	VI	16680
11	Sekretare, daktilografiste	VI	16680
12	Punonjës shërbimi	III	14500
13	Pastruese	I	14000

Tabela nr.2

PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT NË RRETHE

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga në lekë
1	Kryetar dege K1	XXII	33600
2	Kryetar dege K2	XXI	31200
3	Shëf sektori	XXI	31200
4	Specialist i lartë	XX	28200
5	Specialist i mesëm	VIII	17400
6	Kryetar Grupi Gatishmërie	XXI	31200
7	Specialist Grupi Gatishmërie	XIX	26160
8	Arkivist-Protokollist	VI	16680
9	Shofer	IX	18960

**VENDIM
Nr.407, datë 21.6.2006**

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, të cilat kategorizohen si më poshtë vijon:

a) Institucionet qendrore të grupit të parë, ku bëjnë pjesë Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Agjencia Kombëtare e Energjisë, Enti i Turizmit, Komiteti Shtetëror i Kulteve, Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.

b) Institucionet qendrore të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë Instituti i Studimeve të Transportit, Instituti i Studimeve të Urbanistikës, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve, Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë, Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Reparti i Inspektim-Shpëtim Minierave, Drejtoria e Akreditimit, Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve, Policia Elektrike, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave

Publike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Kompania Shtetërore e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, Komiteti Olimpik Shqiptar, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, Kompania Teatrorë, Shtetërore, Qendrore e Teatrit Kombëtar për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar dhe Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit.

c) Institucionet qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Durrës, Inspektorati Hekurudhor, Durrës, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, Inspektorati i Pajisjeve nën Presion, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, Drejtoria e Informacionit Agrorshqimor, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, Sarandë, zyrat e administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike, Agjencia e Shërbimeve të Sportit, Tiranë, Fototeka Kombëtare “Marubi”, Shkodër, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti”, Krujë, Qendra Kombëtare e Muzeumeve, Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë dhe Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë.

2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të parë, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/1 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Zyren Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të jenë sipas lidhjes nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/2 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të jenë sipas lidhjes nr.1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të dytë, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/1 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, të jenë sipas lidhjes nr.2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Punonjësit e trupës artistike të këtyre institucioneve përfitojnë shtesë për kushte pune, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

4. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të tretë, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe në varësi të institucioneve, të përcaktuara në pikën 1, të jenë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/1 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, të jenë sipas lidhjes nr.4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/2 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore, të jenë sipas lidhjes nr.4/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/3 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të drejtorive të burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit në rrethe, të jenë sipas lidhjes nr.4/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr. 2, nr.2/1, nr.3 e nr.4, nr.4/1, nr.4/2, e nr.4/3 — diplomë e shkollës së lartë të jetë 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

7. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr. 2, nr.2/1, nr.3 e nr.4, nr.4/1, nr.4/2, e nr.4/3 jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

8. Shtesa për kualifikim është sipas kolonës 3, të lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr. 2, nr.2/1, nr.3 e nr.4, nr.4/1, nr.4/2, e nr.4/3.

9. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, të lidhjeve nr.1, nr.1/l, nr.1/2, nr. 2, nr.2/1, nr.3 e nr.4, nr.4/1, nr.4/2, e nr.4/3.

10. Kategorizimi për secilin institucion për pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” përcaktohet në urdhrin e miratimit të strukturës dhe të organikës së institucionit.

11. Nëpunësit në pozicionet “Specialist” deri “Titullar i institucionit”, të institucioneve rajonale/vendore, që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë, të trajtohen me pagë sipas strukturës së përcaktuar në lidhjet nr.4, nr.4/1, nr.4/2 e nr.4/3 që i bashkëlidhen këtij vendimi, por paga e grupit të llogaritet me 50 për qind të pagës së grupit për diplomën e shkollës së lartë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 6 të këtij vendimi. Shtesa për vjetërsi për këta nëpunës të llogaritet mbi këtë pagë të reduktuar.

12. Nëpunësit me tituj e grada shkencore (specialist deri në titullar), të cilët punojnë në pozicione që kërkojnë detyrimisht titullin apo gradën shkencore përkatëse, në Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, Institutin e Kurrikulave dhe Standardeve, Agjencinë e Akreditimit për Arsimin e Lartë, Qendrën Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Provimeve, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Institutin e Monumenteve të Kulturës, Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, Komitetin Olimpik Shqiptar, Galerinë Kombëtare të Arteve, Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Bibliotekën Kombëtare, Muzeun Historik Kombëtar, përveç pagës mujore, të përcaktuar sipas lidhjeve nr.1, nr. 2 e nr.3, dhe pikës 11, të këtij vendimi, përfitojnë një shpërblim mujor si më poshtë vijon:

- Profesor 5 600 lekë;
- Profesor i asociuar 4 900 leke;
- Doktor i shkencave 4 200 lekë.

12/1 Numri maksimal i pozicioneve të punës, që kërkojnë detyrimisht punonjës me titull ose gradë shkencore të jetë, si më poshtë vijon:

- Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin 4 (katër);
- Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve 8 (tetë);
- Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë 1 (një);
- Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve 4 (katër).

13. Nëpunësit, që paguhën sipas lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr. 2, nr.2/1, nr.3 e nr.4, nr.4/1, nr.4/2, e nr.4/3, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe pikave 11, 12 dhe 12/1 të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave.

14. Procesi i ristrukturimit të institucioneve, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, të ketë përfunduar deri më datë 15.7.2006. Zbatimi i niveleve të pagave, të përcaktuara sipas këtij vendimi, të fillojë pas përfundimit të këtij procesi dhe miratimit me urdhrin e Kryeministrit të strukturave dhe të organikave të institucioneve të sipërpërmendura.

15. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

16. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore te Grupit te Pare

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%	0	97.713
Zv/titullar i institucionit.	II-b	10.050	2%	0	80.342
Drejtor drejtorie. Anetar i organit drejtues. Koordinator. Menaxher trainimi.	III-a	10.050	2%	0	59.714
Pergjegjes sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942
Pergjegjes sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%	0	43.428
Specialist.	IV-a	10.050	2%	0	32.571
	IV-b	10.050	2%	0	21.714

LIDHJA NR. 1/1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Zyren Qendrore te Regjistrimit
te Pasurive te Paluajtshme

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Kryeregjistruesi.	II-a	10.050	2%	0	97.713	13.000
Zevendeskryeregjistruesi.	II-b	10.050	2%	0	80.342	13.000
Drejtor drejtorie.	III-a	10.050	2%	0	59.714	15.000
Pergjegjes sektori	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	10.000
Pergjegjes sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%	0	43.428	5.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
	IV-b	10.050	2%	0	21.714	5.000

LIDHJA NR. 1/2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit.	II-a	10.050	2%	0	97.713	10.000
Zevendestitullar i institucionit.	II-b	10.050	2%	0	80.342	8.000
Drejtor drejtorie.	III-a	10.050	2%	0	59.714	6.000
Pergjegjes sektori.	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	6.000
Pergjegjes sektori.	III-b	10.050	2%	0	43.428	0
Specialist.	IV-a	10.050	2%	0	32.571	5.000
Inspektor.						
Specialist.	IV-a	10.050	2%	0	21.714	0

LIDHJA NR. 2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore te Grupit te Dyte

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342
Zv/titullar i institucionit. Drejtor drejtorie. Ekspert Mjeko Ligjor ne Institutin e Mjekesise Ligjore.	III-a	10.050	2%	0	59.714
Drejtor Drejtorie. Kryeredaktor ne Qendren e Publikimeve Zyrtare. Pergjegjes sektori.	III-a/1	10.050	2%	0	49.942
Pergjegjes sektori. Redaktor i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Informaticien i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Inspektor. Dirigjent. Regjisor.	III-b	10.050	2%	0	43.428
Specialist.	IV-a	10.050	2%	0	32.571
Solist. Orkestrant.	IV-b	10.050	2%	0	21.714

LIDHJA NR. 2/1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Teatrin Kombetar dhe Teatrin Kombetar te Operas dhe Baletit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0	80.342
Zv/titullar i institucionit. Drejtor drejtorie.	III-a	10.050	2%	0	59.714
Dirigjent. Regjisor. Pergjegjes sektori. Solist i pare. Koncertamaester. Baletmaester. Aktor.	III-a/1	10.050	2%	0	49.942
Asistent dirigjent. Asistent regjisor. Solist II (spala sektori). Aktor.	III-b	10.050	2%	0	43.428
Specialist. Orkestrant. Korist. Balerin. Aktor. Mjek. Skenograf.	IV-a	10.050	2%	0	32.571
	IV-b	10.050	2%	0	21.714

Aktor. Mjek. Korrektor i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Skenograf. Kurator. Inspektor. Bibliograf. Klasifikator. Bibliotekar. Restaurator. Lektor. Administrator. Redaktor. Korist. Valltar. Studiues.					
---	--	--	--	--	--

Shenim: Punonjesit e trupes artistike te Kompanise Shteterore te Ansamblit te Kengeve dhe Valleve Popullore dhe te Kompanise Teatrore, Shteterore, Qendrore te Teatrit Kombetar per Femije, perfitojne nje shtese per kushte pune ne masen 5.000 leke ne muaj.

LIDHJA NR. 2/1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Teatrin Kombetar dhe Teatrin Kombetar te Operas dhe Baletit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)				PAGA MUJORE
					SHTESA E POZICIONIT	SHTESA e pozicionit (SHP)
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)		
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%	0		80.342
Zv/titullar i institucionit. Drejtor drejtorie.	III-a	10.050	2%	0		59.714
Dirigjent. Regjisor. Pergjegjes sektori. Solist i pare. Koncertamaester. Baletmaester. Aktor.	III-a/1	10.050	2%	0		49.942
Asistent dirigjent. Asistent regjisor. Solist II (spala sektori). Aktor.	III-b	10.050	2%	0		43.428
Specialist. Orkestrant. Korist. Balerin. Aktor. Mjek. Skenograf.	IV-a	10.050	2%	0		32.571
	IV-b	10.050	2%	0		21.714

LIDHJA NR. 3

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore te Grupit te Trete

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit. Kapiten i Pergjithshem i Kapitenerise se Pergjithshme te Porteve.	III-a	10.050	2%	0	59.714
Drejtor drejtorie. Zv/kapiten i Kapitenerise se Pergjithshme te Porteve.	III-b	10.050	2%	0	43.428
Pergjegjes sektori. Inspektor.	IV-a	10.050	2%	0	32.571
Specialist. Restaurator. Lektor. Arkivist/katalogist. Historian.	IV-b	10.050	2%	0	21.714
	IV-c	10.050	2%	0	16.286

LIDHJA NR. 4

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te institucioneve rajonale/vendore ne varesi te ministrave te linjes, si dhe institucioneve qendrore ne varesi te ministrave te linjes

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor i Policise Elektrike.	III-a	10.050	2%	0	59.714
Titullar i institucionit rajonal. Kryetar i Zyres se Permbarimit. Pergjegjes sektori ne Policine Elektrike ne Qarqe.	III-b	10.050	2%	0	43.428
Titullar i institucionit vendor. Pergjegjes sektori ne institucionet rajonale. Permbarues Gjyqesor ne Zyrat e Permbarimit Gjyqesor. Specialist ne Policine Elektrike ne Qarqe.	IV-a	10.050	2%	0	32.571
Pergjegjes sektori i institucionit vendor. Specialist ne institucionet rajonale. Restaurator arti. Arkitekt.	IV-b	10.050	2%	0	21.714
Specialist ne institucionet vendore. Restaurator. Instruktor. Piktor.	IV-c	10.050	2%	0	16.286

LIDHJA NR. 4/1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Zyrtave te Regjistrimit te Pasurive
te Paluajtshme ne rrethe

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Kryeregjistrues i Tiranës	III-a	10.050	2%	0	59.714	15.000
Kryeregjistrues i rretheve te kategorise se I-re.	III-a/1	10.050	2%	0	49.942	16.500
Kryeregjistrues i rretheve te kategorise se II-te. Zevendeskryeregjistrues i rretheve te kategorise se I-re.	III-b	10.050	2%	0	43.428	16.500
Zv/kryeregjistrues ne zyrtat e kategorise se II-te.	IV-a	10.050	2%	0	32.571	16.500
Pergjegjes sektori ne zyrtat e regjistrimit te kategorise se I-re.	IV-a	10.050	2%	0	32.571	10.000
Pergjegjes sektori ne zyrtat e regjistrimit te kategorise se II-te. Specialist ne zyrtat e regjistrimit te kategorise se I-re.	IV-b	10.050	2%	0	21.714	10.000
Specialist ne zyrtat e regjistrimit te kategorise se II-te.	IV-c	10.050	2%	0	16.286	6.000

Shenim: Zyrtat e Regjistrimit te kategorise se I-re jane zyrtat Berat, Durres, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Kavaje, Korçe, Lezhe, Lushnje, Pogradec, Shkoder, Vlore, Diber dhe Sarande.

LIDHJA NR. 4/2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejt看 i Drejtorive Arsimore Rajonale.	III-b	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	43.428
Drejt看 i Zyrave Arsimore. Pergjegjes sektori ne Drejtorite Arsimore Rajonale.	IV-a	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	32.571
Pergjegjes sektori ne Zyrat Arsimore. Specialist ne Drejtorite Arsimore Rajonale.	IV-b	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	21.714
Specialist ne Zyrat Arsimore.	IV-c	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	16.286

LIDHJA NR. 4/3Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Drejtorite e Burgjeve dhe
Institucionet e Riedukimit ne rrethe

POZICIONI	KATEGO RIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICION IT	SHTESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtes a per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	III-a	10.050	2%	0	59.714	10.000
Zevendestitullar i institucionit.	III-b	10.050	2%	0	43.428	8.000
Pergjegjes sektori.	IV-a	10.050	2%	0	32.571	5.000
Specialist.	IV-b	10.050	2%	0	21.714	4.000

VENDIM**Nr.408, datë 21.6.2006****PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AVOKATIT TË POPULLIT, TË DISA
MJEDISEVE PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËTIJ INSTITUCIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Avokati i Popullit të zyrave të katit të parë dhe të dytë, në ndërtesën e ish-Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Avokati i Popullit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KATI I (PERDHE)



ARR. JETA SRENOERAGA
 NIP LIPENSE A.0200/2
Amog



PLANVENDOSJA E ZYRAVE SIPAS DREJTORIJE
KATI I II

ARXITEKTA SHENJEDHJA
NO DIFENSE A.C.P.O.

Handwritten signature

VENDIM
Nr.409, datë 21.6.2006

PËR DHËNIEN ME QIRA, PA KONKURRIM, SHKOLLËS “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”, TË MJEDISEVE NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie me qira, pa konkurrim, shkollës “Tirana International School”, të mjediseve, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në rrugën “3 vëllezërit Kondi”, me sipërfaqe të përgjithshme 4 995 m² nga e cila nën objekt 827 m² të quajtura “Grupi i vilave gjermane”, në Tiranë.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës autorizohet për lidhjen e kontratës së qirasë, me afat 20 vjet, dhe me qira mujore sipas procedurave përkatëse.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.414, datë 7.6.2006

PËR KRYERJEN NGA POSTA SHQIPTARE SHA, TË SHËRBIMEVE, POSTARE DHE FINANCIARE, TË MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 pika 1, 8, pika 5, e 11, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrinë, institucionet buxhetore, ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital shtetëror, shërbimet bazë postare të postës së letrave t’i realizojnë nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a.

2. Shpërndarja e faturave të konsumatorëve, të lëshuara nga KESH sh.a, Albtelecom, sh.a., dhe shoqëritë tregtare të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të bëhet nga Posta Shqiptare sh.a., me tarifa të reduktuara, deri në 50 për qind, të postës së letrave.

3. Arkëtimet për pagesat në shuma jo më të mëdha se 100 000 (njëqind mijë) lekë, për transaksion, të bëhen edhe pranë sporteleve të Postës Shqiptare sh.a., për:

a) licencat dhe lejet e lëshuara nga ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë;

b) gjobat e vendosura nga ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

4. Arkëtimet për pagesat e faturave të lëshuara për abonentët familjarë, nga KESH, sh.a., Albtelecom sh.a., dhe shoqëritë tregtare të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të kryhen edhe në sportelet e Postës Shqiptare, sh.a.

5. Posta Shqiptare, sh.a., të lidhë kontrata me KESH sh.a., Albtelecom, sh.a., dhe shoqëritë tregtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., për kryerjen e shërbimeve të arkëtim-pagesave.

6. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.415, datë 28.6.2006

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KOMPANIE USHTARAKE SLOVENE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, date 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kompanisë ushtarake të transportit, SIKON KFOR, të Forcave të Armatosura të Republikës së Sllovenisë, të përbërë prej 90 (nëntëdhjetë) trupash dhe 41 (dyzet e një) mjetesh ushtarake, të kalojë transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë për në Republikën e Maqedonisë.

2. Hyrja e trupave ushtarake sllovene, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të bëhet në portin e Durrësit, më datë 29.6.2006. Lëvizja e karvanit ushtarak, gjatë kalimit transit, do të ndjekë itinerarin Durrës-Elbasan-Qafë-Thanë. Dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë të bëhet në pikën e kontrollit të kalimit kufitar Qafë-Thanë me datë 30.6.2006.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/dhe nga Republika e Shqipërisë, janë parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, me 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve pale në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, me 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Karvani ushtarak slloven, gjatë itinerarit të lëvizjes të shoqërohet nga një njësi e armatosur e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.416, datë 28.6.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS
DHE TË USHQMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e fundit të pikës 1 të vendimit nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të hiqen fjalët “... duke u bazuar në të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 3.7.2006
Doli nga shtypi më 5.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 200 lekë